

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “LAGERTHA” shpk

Sot në Tiranë më datë 07.01.2025, unë Ortaku dhe themelues i vetëm:

1. **Znj. Flogerta Frroku**, atësia Arben, shtetase Shqiptare, lindur në Këçirë, Pukë dhe banuese në Tiranë, me adresë 3 Deshmoret; Nd. 965; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 6; lindur më 25/07/1988, gjendja civile “e divorcuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 038626158 dhe nr. personal I85725068C

Vendosa të themeloj e të nënshkruajë këtë akt themelimi dhe statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“LAGERTHA” shpk**. Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga ky akt themelimi, statuti i shoqërisë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 1

Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i shoqërisë është **“LAGERTHA” shpk**.

Neni 2

Forma Ligjore

- 2.1 Shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 2.2 Shoqëria është person juridik shqiptar e cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe këtë statut.

Neni 3


Selia

- 3.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: **Rruga “Pjetër Bogdani”, Pll. Vila-L, shkalla 3, Kati përdhe, Njësi Shërbimi Nr. 12 dhe 13, kulla lindore, Zk. 2679, Tirane.**
- 3.2 Shoqëria mund të shtrijë aktivitetin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 3.3 Ajo mund të themelojë degë ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.
- 3.4 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Periudha e aktivitetit të shoqërisë është pa afat



NENI 5

Objekti i Shoqërisë

- 5.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë të kryejë çdo aktivitet tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanërisht si më poshtë:
- i. Tregti me shumice dhe pakice, import-eksport, të mallrave industriale, metrazheve të ndryshme, konfeksione dhe tekstile dhe çdo lloj produkti të tekstileve dhe metrazheve por jo vetëm.
 - ii. Import të makinerive të ndryshme për perpunimin e tekstileve dhe metrazheve.
 - iii. Transporti për llogari të vet dhe të tretëve, që do të kryhet me mjetet e tyre dhe / ose palëve të treta, brënda dhe jashtë vendit;
- 5.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëlimeve të shoqërisë që nuk bien ndesh me ligjet Shqiptare në fuqi.
- 5.3 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë statut.
- 5.4 Shoqëria mund të marrë te drejtën e përfaqësimit në Shqipëri të individëve, shoqërive apo organizatave vendase apo të huaja .

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar, Kuotat e Kapitalit Themeltar

Neni 6

Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 5.000.000 (pesë milion) lekë, do të depozitohet në llogari të shoqërisë, në një Bankë të nivelit të dytë, pas regjistrimit në QKB .

Neni 7

Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat

- 7.1 Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat e zotëruar prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:
- **FLOGERTA FRROKU** zotëron 1 kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë

Neni 8


Transferimi i kuotave ndërmjet ortakëve

Kuotat e kapitalit themeltar janë të transferueshme sipas parashikimeve të statutit.

Neni 9

Organet e shoqërisë

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:



- Administratorët
- Asambleja e Përgjithshme

Neni 10

Administratori

Administratori i shoqërisë është:

- **Znj. Flogerta Frroku**, lindur në Këçirë, Pukë dhe banuese në Tiranë, me adresë rr. "3 Deshmoret", Nd. 965; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 6; lindur më 25/07/1988, gjendja civile "e divorcuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 038626158 dhe nr. personal I85725068C, do të jetë Administrator i Shoqërisë.

Neni 11

Kompetencat e Administratorit

Kompetencat e administratorit janë sipas statutit të shoqërisë dhe ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12

Fuqia e akteve

Të gjitha çështjet për të cilat ky akt themelimi nuk i parashikon ose nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të cilat parashikojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kontrollit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Ky akt themelimi është bërë në 2 kopje me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKU I SHOQËRISË

FLOGERTA FRROKU



STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“LAGERTHA” sh.p.k

KAPITULLI I

Emri, Forma, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1

Data e Themelimit dhe Emri

- 1.1 Sot në datën 07.01.2025, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**LAGERTHA**” sh.p.k (në vijim “Shoqëria”), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “shpk”, e cila përfaqëson formën ligjore të saj, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.2 Ortakët e Shoqërisë (Ortakët) gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e Shoqërisë të përfaqësuar në Kuota.
- 1.3 Në të gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyrë e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do të shoqërohet nga:
- Fjalët “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shpk”
 - Numrin unik të identifikimit;
 - Formën ligjore të shoqërisë;
 - Vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - Të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
 - Logo e shoqërisë.
 - Emri i shoqërisë “**LAGERTHA**” shpk
 - Emri Tregtar “**LAGERTHA**”.
 - Nëse shoqëria ka faqe internet, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

Neni 2

Forma Ligjore

- 2.1 Shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 2.2 Shoqëria është person juridik shqiptar e cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe këtë statut.

Neni 3

Selia

- 3.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: **Rruga “Pjetër Bogdani”, Pll. Vila-L, shkalla 3, Kati përdhe, Njësi Shërbimi Nr. 12 dhe 13, kulla lindore, Zk. 2679, Tirane.**
- 3.2 Shoqëria mund të shtrijë aktivitetin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 3.3 Ajo mund të themelojë degë ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.
- 3.4 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.



Neni 4
Kohëzgjatja

- 4.1 Periudha e aktivitetit të shoqërisë është pa afat

KAPITULLI II

NENI 5
Objekti i Shoqërisë

- 5.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë të kryejë çdo aktivitet tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanërisht si më poshtë:
- i. Tregti me shumice dhe pakice, import-eksport, të mallrave industriale, metrazheve të ndryshme, konfeksione dhe tekstile dhe çdo lloj produkti të tekstileve dhe metrazheve por jo vetëm.
 - ii. Import të makinerive të ndryshme për perpunimin e tekstileve dhe metrazheve.
 - iii. Transporti për llogari të vet dhe të tretëve, që do të kryhet me mjetet e tyre dhe / ose palëve të treta, brënda dhe jashtë vendit;
- 5.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëlimeve të shoqërisë që nuk bien ndesh me ligjet Shqiptare në fuqi.
- 5.3 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë statut.
- 5.4 Shoqëria mund të marrë te drejtën e përfaqësimit në Shqipëri të individëve, shoqërive apo organizatave vendase apo të huaja .

KAPITULLI III
Kapitali Themeltar, Kuotat e Kapitalit Themeltar

Neni 6
Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 5.000.000 (pesë milion) lekë, do të depozitohet në llogari të shoqërisë, në një Bankë të nivelit të dytë, pas regjistrimit në QKB .

Neni 7
Ortakët e Shoqërisë dhe Kuotat

- 7.1 Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat e zotëruar prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:
- **FLOGERTA FRROKU** zotëron 1 kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë.



Neni 8
Zvogëlimi osë Zmadhimi i Kapitalit Themeltar


- 8.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti dhe kërkesave të detyrueshme të lëgjit të shoqërive
- 8.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave (nëse ka) dhe fitimit.
- 8.3 Rritja e kapitalit do të bëhet me kuota të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.
- 8.4 Zmadhimi i kapitalit nuk do të dobësojë pjesët e interest të Ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë, përveçse kur ortakët do të bien dakort ndryshe me vendim unanim të Ortakëve.
- 8.5 Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj.
Megjithatë me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Ortakët mund të autorizojnë Administratorin/Administratorët të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse apo pjesëve të tyre dhe ti anulojnë ato.

Neni 9
Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

- 9.1 Ortakët janë vetëm ata të cilët zotërojnë kuotat e Shoqërisë
- 9.2 Çdo Ortak do të ketë të drejta vote në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve në përpjestim me vlerën nominale të kuotës që zotëron. Çdo Ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejtat e parashikuara nga Statut, për çdo marrëveshje të detyrueshme nëpërmjet Ortakëve dhe dispozitave ligjore të ligjit të Shoqërive.
- 9.3 Ortakëve do t'u jepen, me kërkesë me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e shoqërisë në cdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentat dhe raportet e Shoqërisë.
- 9.4 Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave, transferohen tek cdo zotërues i ri për këto kuota.
- 9.5 Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj dhe Ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brënda limitit të vlerës së kuotave që ata zotërojnë. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimin etyre përkatësisht në Shoqëri (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë).
- 9.6 Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose setyime të tjera të Ortakëve të tij.

Neni 10
Transferimi i pjesëve të Kapitalit

- 10.1 Pjesët e kapitalit transferohen lirisht midis ortakëve
- 10.2 Në rast se një ortak do të shesë, transferojë, ose të disponojë në mënyra të ndryshme pjesë apo të gjithë kuotën e tij, ortaku tjetër do të ketë të drejtën e parablerjes, kundrejt blerësve të tjerë. Nëse ortaku me të drejtë parablerje do të ketë bërë një ofertë dhe kjo ofertë është refuzuar nga



ortaku që shet, atëherë ortaku që shet nuk do të ketë të drejtë të shesë kuotën tek një blerës tjetër me cmim më të ulët se cmimi i ofruar nga ortaku i preferuar.

- 10.3 Çdo transferim i kuotave do të bëhet në përputhje me dipsozitat e ligjit të Shoqërive dhe duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

KREU V **Asambleja e Përgjithshme**

Neni 11 **Kompetencat**


- 11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi drejtues i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike

Neni 12 **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën 1 (një) herë në vit.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivitete e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, asete të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të gjithë aseteve të Shoqërisë, sic rezulton në pasqyrat e fundit finaciare të certifikuara. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bazën e raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, që do ti paraqitet Asamblesë, përvec rastit kur kjo blerje bëhet në Bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme, e tregtare të Shoqërisë
- 12.4 Asambleja e përgjithshme thirret kur Shoqëria, brënda 2 (dy) viteve të para, pas regjistrimit të saj propozon blerje nga një ortak, që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë, sic rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 12.5 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 12.3 dhe 12.4, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje bëhet në bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme të Shoqërisë.
- 12.6 Ortakët do të organizojnë takim me Administratorët cdo 3 (tre) muaj me qëllim vlerësimin e veprimeve të kryera nga Administratorët gjatë këtij 3 mujori, diskutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë dhe marrjen e vendimeve mbi çështjet që janë objekt i aprovimit nga ana tyre, përfshirë çështjet për të cilat Administratorët nuk bien dakort.
- 12.7 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 12.3 dhe 12.6, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e Administratorëve.

Neni 13 **Mënyra e Thirrjes**

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të vendosë për çështjet e shtruara përpara saj nëpërmjet thirrjes së mbledhjeve ose nëpërmjet konsultave me shkrim.



- 13.2 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga një prej Administratorëve ose nga cdonjëri prej ortakëve.
- 13.3 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e Shoqërisë, në selinë e një dege të Tiranës, në cdo qytet të Shqipërisë apo në cdo qytet apo provincë të Botës sic bihet dakort midis ortakëve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e këtyre takimeve si dhe rendi i ditës përkatës i mbledhjes ju njoftohet ortakëve me postë të regjistruar të paktën 7 ditë para mbledhjes. Në rast se Asambleja e Përfhithshme nuk është thirrur në përputhje me kërkesat e këtij paragrafi, kjo e fundit mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë Ortakët bien dakort.
- 13.4 Secili nga ortakët gëzon të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të ligjit për “Shoqëritë Tregtare”.
- 13.5 Ortakët pranojnë dhe bien dakort me të drejtën për të marrë vendime në lidhje me Shoqërinë në formë të shkruar. Rezoluta e propozuar sëbashku me dokumentacionin mbështetës do t’ju dërgohet ortakëve me postë, korrier, email, ose mënyra tjera elektronike të sigurta. Ortaku do të marrë vendim për rezolutën përkatëse brenda një periudhe prej 15 ditësh, nga dita që i është dorëzuar rezoluta. Ortaku (ët) miratojnë rezolutën duke i kthyer Administratorit (ve) të Shoqërisë një kopje të firmosur të rezolutës me shkrim. Ortakët të cilët nuk janë dakort me rezolutën shprehin me shkrim kundërshtimet e tyre në lidhje me rezolutën dhe i’a kthejnë atë Administratorit(ëve) të Shoqërisë. Rezoluta me shkrim Konsiderohet e miratuar nëse aprovohet nga shumica e kërkuar në përputhje me nenin 12, më sipër.
- 13.6 Secili prej Ortakëve ka të drejtën të votojë në përputhje me kuotën e zotëruar prej tij në capital.
- 13.7 Vendimet e mëposhtme do të miratohen me miratimin e ortakëve që zotërojnë të paktën 75% të kapitalit të shoqërisë:
- i. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - ii. ndryshimet e statutit;
 - iii. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - iv. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - v. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - vi. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - vii. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - viii. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - ix. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - x. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - xi. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - xii. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - xiii. shitjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë;
 - xiv. blerjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme;
 - xv. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 14

Përfashtim nga e drejta e votës

- 14.1 Një nga ortakët përfashtohet nga e drejta e votës në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:
- i. Vlerësimin e veprimtarisë së këtij ortaku.
 - ii. Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
 - iii. Ngritjen e një padie kundër tij, nga Shoqëria.



- iv. Dhënien ose jot ë përfitimeve të reja.
- 14.2 Kur ky ortak është i përfaqësuar nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi sikundër ortaku të cilin përfaqëson.

KREU V

Administratori

Neni 15

Administratori dhe Kompetencat

- 15.1 Shoqëria drejtohet nga Administratori. Administratorët mund të jenë të cdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jenë rezidentë në Shqipëri
- 15.2 **Znj. Flogerta Frroku**, lindur në Këçirë, Pukë dhe banuese në Tiranë, me adresë rr. "3 Deshmoret", Nd. 965; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 6; lindur më 25/07/1988, gjendja civile "e divorcuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 038626158 dhe nr. personal I85725068C, do të jetë Administrator i Shoqërisë.
- 15.3 Kohëzgjatja e Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, duke filluar që nga moment kur kjo detyrë merr fuqi ligjore (dmth në momentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit), me të drejtë ripërtëritje të këtij afati.

Neni 16

Kompetencat dhe detyrimet

- 16.1 Secili prej administratorëve, në mënyrë individuale ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, gjithmonë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë duke u kufizuar në ato kompetenca që ligji ose ky statut ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.
- 16.2 Administratori i shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime:
- i. Përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
 - ii. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - iii. Miraton rregulloret përkatëse të punës, si dhe emëron e shkarkon punonjësit e shoqërisë;
 - iv. Merr me qira ambiente për shoqërinë si dhe mund të jap me qira ambientet e shoqërisë.
 - v. Miraton pagat e punonjësve.
 - vi. Përcakton tarifat e shërbimit si dhe blen e shet në emër të shoqërisë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.
 - vii. Për plotësimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë përveç angazhimit të punonjësve të saj, mund të angazhojë me kontrata shërbimi dhe ekspertë të tjerë;
 - viii. Kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ix. Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - x. Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërkojnë marrëveshjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - xi. Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

- xii. Raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Neni 17

Detyrimi i besnikërtisë dhe përgjegjësia

- 17.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,16,17,18 të ligjit për “Shoqëritë Tregtare”, Administratorët detyrohen:
- i. Të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në këtë statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi.
 - ii. Të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.
 - iii. Të parandalojnë dhe menjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë.
 - iv. Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm .
- 17.2 Administratorët, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre përgjigjen kundrejt Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprim apo mosveprim është kryer në mirëbesim.
- 17.3 Në rast të shkeljes së detyrës dhe standarteve profesionale, sipa pikave 17.1 dh 17.2 të këtij neni, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare
- 17.4 Në vecanti, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet, në qoftëse në kundërshtim me ligjin e Shoqërive Tregtare kryen veprimet e mëposhtëme:
- i. I kthen Ortakëve kontributet;
 - ii. I paguan ortakëve interesat individuale apo dividende;
 - iii. I shpërndan asetet shoqërisë;
 - iv. Lejon që shoqëria të vazhdojë aktivitetin e saj, kur duhet ta kishte paralajmëruar që kjo e fundit nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet e saj;
 - v. Jep hua.

KREU VI

Administrimi Financiar i Shoqërisë

Neni 18

Eksperti Kontabël i Autorizuar

- 18.1 Ortakët mund të caktojnë ekspertin kontabël të autorizuar për ti shërbyer Shoqërisë.
- 18.2 Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në prputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII

Aktiviteti i Shoqërisë



Neni 19
Viti Ekonomiko-Financiar

- 19.1 Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-t të muajit dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis në datën e themelimit të Shoqërisë.

Neni 20
Mbajtja e Llogarive

- 20.1 Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj.

Neni 21
Llogaritja dhe Shpërndarja e fitimit

- 21.1 Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, marrëveshjen e ortakëve dhe ligjin e zbatueshëm.
- 21.2 Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezervë në përputhje me kushtet e legjislacionit Shqiptar për fondin rezervë të detyrueshëm.
- 21.3 Në bazë të ligjit për Shoqëritë Tregtare, shoqëria mund të shpërndajë fitimin vetëm nës pas kësaj shpërndarje:
- i. Asetet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit
 - ii. Shoqëria ka aktive, likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve të ardhshëm.
- 21.4 Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 21.3 të nenit të sipërcituar. Ndërsa kur gjëndja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
- 21.5 Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

KREU VIII
Modifikimi i Formës Ligjore. Prishja.

Neni 22
Modifikimi i formës ligjore

- 22.1 Forma ligjore e shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me dispozitat respective të legjislacionit Shqiptar.
- 22.2 Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

Neni 23
Prishja e Shoqërisë

- 23.1 Shoqëria mund të priset në rrethanat e mëposhtme:
- i. Si pasojë e përfundimit të kohëzgjatjes për të cilën ishte themeluar;
 - ii. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - iii. Hapje të një procedure falimentimi;



- iv. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - v. Me vendim gjykate;
 - vi. Për arsye të tjera të përcaktuara nga ortakët në cdo kohë;
- 23.2** Administratori(et) regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me nenin 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Në rast se prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata në përputhje me nenin 45 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ia njofton vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

KREU X

Të ndryshme

Neni 24

Të tjera

- 24.1** Cdo gjë tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Neni 25

Fuqia e akteve

Të gjitha çështjet për të cilat Statuti nuk i parashikon ose nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të cilat parashikojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kontrollit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

ORTAKU I SHOQËRISË

FLOGERTA FRROKU

